



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost  
Kosovo Academy for Public Safety

**Datë: 03.11.2022**

Bazuar në Rregulloren (QRK) – Nr.05/202019 për Arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, si dhe Rregulloren (QRK) – Nr.25/2013 për Pagesat e personelit Trajnues dhe Mësimdhënës si dhe Eksperteve të fushave Funktionale, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, **rishpall:**

## **K O N K U R S**

Për angazhimin (me honorar) të personelit mësimdhënës në Fakultetin e Sigurisë Publike, për vitin akademik 2022/2023

### **I. Drejtimi: Policia dhe Inspektorati Policor**

<b>Semestri IV / Dimëror</b>		
<b>Nr</b>	<b>Lëndët</b>	<b>Statusi</b>
<b>1</b>	Siguria Kombëtare	Obligative

### **II. Drejtimi: Menaxhimi Emergjent**

<b>Semestri V / Dimëror</b>		
<b>Nr</b>	<b>Lëndët</b>	<b>Statusi</b>
<b>1</b>	Dizajnimi i Ushtrimeve	Obligative
<b>2</b>	Menaxhimi Emergjent dhe Terrorizmi	Obligative

*Për lëndë zgjedhore kontrata do të lidhet me mësimdhënësin vetëm nëse lënda zgjidhet (formohet grupi) nga studentet.*

***Konkursi është intern (brenda institucioneve të sigurisë) andaj të drejtë aplikimi kanë vetëm zyrtaret e punësuar në institucionet e sigurisë publike, si: Policia e Kosovës, Inspektorati i Policisë së Kosovës, Dogana e Kosovës, Agjencia e Menaxhimit Emergjent e Kosovës, Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës.***

**Zyrtaret e Institucioneve të Sigurisë, mund të aplikojnë vetëm në lëndën/lëndët nga drejtimi sipas institucionit punëdhënës, shembull: për lëndët nga drejtimi Policia dhe Inspektorati Policor mund të aplikojnë vetëm zyrtaret e Policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës të cilët plotësojnë kriteret e konkursit.**

Kandidatet e interesuar duhet të kenë gradë shkencore se paku master/magjistraturë apo ekuivalent dhe përvojë profesionale në fushën e lëndës që aplikon.

Përzgjedhja e personelit të angazhuar do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores për arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kompensimi për personelin e angazhuar (me honorar) do të bëhet vetëm për orët e mbajtura, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) – Nr.25/2013 për Pagesat e personelit Trajnues dhe Mësimdhënës si dhe Eksperteve të fushave Funktionale.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim (të specifikohet lënda për cilën aplikon);
- Një cv profesionale;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kontratën e punës dhe një vërtetim se i njëjti ende është në marrëdhënie pune në Institucionin e Sigurisë.
- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë dhe doktoratës (të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- **Një referencë nga punëdhënësi**
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
- Si dhe informata tjera të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr.01.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur **5 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes, respektivisht nga data **03.11.2022** deri me datën **07.11.2022**, në ora 16:00.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve, do të njoftohen vetëm kandidatet e përzgjedhur për angazhim.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore, në numrin e tel: 028 590 070 Ext 210, prej orës 08:00 - 1600.